

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S. I. nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës-Divizioni i Furnizimit në Prishtinë për anulimin e vendimit mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe kthimit në punë, duke vendosur përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1657/2016 datë 09.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit S. I. nga ..., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1657/2016 datë 09.07.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1657/2016 datë 09.07.2018, është aprovuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës-Divizioni i Furnizimit në Prishtinë dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2162/2015 datë 29.02.2016, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S. I. nga ..., me të cilin ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurës nr..., i datës ..., dhe vendimi nr..., i datës ..., me të cilin paditësit i është shkëputur kontrata e punës nr..., dhe të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës sipas kontratës nr..., me të gjitha të drejtat dhe detyrat e punës nga dita e largimit nga puna e deri në kthimin në punë si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 527,80 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas pranimit të aktgjykimit. Njëherit u vendos që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në afat ligjor ka parashtruar revizion paditësi për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që revizioni të aprovohet dhe të priset

aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë gjersa të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e goditur dhe pretendimet e revizionit dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ishte i punësuar te e paditura në kohë të caktuar sipas kontratës së fundit nr..., datë ..., në vendin e punës Specialist i daljeve. E paditura me njoftimin e saj nr..., datë ..., e njofton paditësin mbi shkëputjen e kontratës së punës për arsye se paditësi sa ishte i punësuar te e paditura i njëjti ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik konsumatores L. H., pa autorizim ditën e shtunë për të cilin shërbim i ka marrë shumën e parave në lartësi prej 20 €. Ndërrimi i njehsorit është bërë në kundërshtim me procedurat e ndërrimit të njehsorëve. Paditësit edhe më parë i është shqiptuar vërejtja e fundit me shkrim nr..., datë ..., për shkak të preformancës së dobët për muajin prill 2009, si dhe refuzimit të bashkëpunimit mos durimit personal dhe për shkak të shkaqeve tjera të arsyeshme. Këtë e konstaton edhe komisioni përkatës i të paditurës të cilën gjë nuk e mohon as paditësi. Lidhur me veprimet e paditësit e paditura zbaton procedurën përkatëse disiplinore dhe e njofton paditësin me njoftimin nr..., datë ..., për shkëputjen e kontratës së punës e në bazë të nenit 8.12 të Rregullores nr.2 për operacionet e distrikteve të KEK-ut. Kundër njoftimit për shkëputjen e kontratës së punës paditësi ka ushtruar ankesë e cila është refuzuar si e pabazuar me vendimin nr..., datë ..., të Drejtorit të furnizimit të paditurës për shkak të shkeljeve të detyrave të punës nga neni 8.12, 8.13, 8.14, të Rregullores nr.2 për operacionet e distrikteve të KEK-ut si dhe nenit 11.2 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë. Para marrjes së njoftimit e paditura e ka caktuar takimin me punëmarrësin e në bazë të nenit 11.5 të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, dhe nenit 8.4 të Rregullores për operacionet e distrikteve të paditurës me datë 16.11.2009, në ora 10:20 dhe pas kësaj paditësi-punëmarrësi është njoftuar për shkëputjen e kontratës së punës. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i sindikatës S.K., dhe se lidhur me këtë është përpiluar edhe procesverbali nr.238 datë 16.11.2009, dhe se punëmarrësi është njoftuar për shkaqet e shkëputjes e kontratës së punës.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike ka vlerësuar se për shkelje të detyrave të punës në të cilat janë bazuar vendimet e paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit është masë e rëndë e shqiptuar disiplinore nga se e paditura nuk ka pasur kurrfarë dëmi kurse veprimet e paditësit më shumë kanë të bëjnë me sjelljen në kundërshtim me standarde profesionale dhe etike në vendin e punës. Nga kjo arsye e anulon si të kundërligjshëm njoftimin e të paditurës për shkëputje të kontratës së punës dhe e detyron të paditurën që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimit gjen se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye duke u bazuar në dispozitën e nenit 201 të LPK, e ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit e më afërsisht të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë me zbatimin të drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore ka vendosur drejt kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për çfarë arsye e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore siç pretendohet në revizion e as me shkelje të cilat gjykata i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Këtë pikëpamje juridike Gjykata Supreme mori për faktin se në bazë të nenit 11.5 të Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës i cili ka hy në fuqi me 8 tetor 2001, saktësisht është përcaktuar se kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi. Punëdhënësi do të njoftoj punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës ashtu që në njoftim theksohet edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe punëdhënësi do ta mbajë një takim me punonjësin me të cilin rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punëmarrësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Po ashtu në bazë të nenit 8.4 të Rregullores për operacionet e distrikteve të paditurës saktësisht parashihet se në rast të shkeljeve të detyrave të punës të cilat përfaqësojnë bazë për shkëputjen e kontratës së punës. E paditura në rastin konkret i ka respektuar dispozitat të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë pikërisht nenin 11.5 nën pikën (a) dhe (b) e lidhur me nenin 8 të Rregullores për operacionet e distrikteve të paditurës me rastin e shkëputjes e kontratës së punës të punëmarrësit.

Gjykata Supreme konsideron se njoftimi përkatësisht vendimi i të paditurës anulimi i të cilit kërkohet nuk është i kundërligjshëm për arsye se është marrë në bazë të dispozitave të ligjeve të cekura më lart. Njëherit kërkesa e paditësit lidhur me kthimin në punë nuk ka bazë ligjore për arsye se paditësi të e paditura ka themeluar marrëdhënien e punës me kontratë nr.11738/0 me afat të caktuar prej datës 01.10.2009 deri më 31.12.2009. Me dispozitën e nenit 11.1 nën pikën (e) për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë parashihet se kontrata e punës shkëputet ndër të tjera edhe me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit. Kërkesëpadia e paditësit për kthimin në punë nuk ka bazë ligjore meqë afati i kohës së lidhjes së kontratës ka skaduar me kalimin e kohës për të cilën është lidhur kontrata, kështu që çështja e vazhdimit të kontratës së punës të paditësit pas skadimit të afatit është në diskrecion e të paditurës. Prandaj, janë të paqëndrueshme parashtrimet në revizion lidhur me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Nga arsyet e cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në pajtim me nenin 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.377/2018 datë 20.11.2018

Kryetar i kolegjit,
Isa Kelmendi